



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

# Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2024

Nëntor 2023



©Akademia e Drejtësisë 2023, Të gjitha të drejtat e rezervuara Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2024 është miratuar nga Këshilli  
Drejtues i Akademisë me datën 29.11.2023

## Tabela e përmbajtjes

1. Lista e shkurtesave .....	6
2. Hyrje .....	7
3. Përmbushja e Planit të punës dhe të Performancës për vitin 2023 dhe sfidat gjatë realizimit të tij .....	7
Rëndësia e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2024 .....	10
Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë .....	10
Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	11
Këshilli Drejtues .....	11
Këshilli Programor.....	11
Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.....	12
Objektivat e Planit të Punës për vitin 2024.....	12
<b>Objekti I: Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar - PTF</b> .....	12
1.1 Zbatimin e trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X .....	13
1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X.....	14
1.3 Zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të sapo emëruar dhe për komunitetin serb.....	14
1.4 Zbatimin e trajnimit fillestar për 8 gjyqtarët nga komuniteti serbë të sapo emëruar të gjeneratës e XII në trajnimin teorik dhe praktik. ....	15
1.5 Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI trajnimi teorik dhe trajnimin praktik.....	15
1.6 Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII në trajnimin teorik dhe praktik. ....	16
<b>Objekti II: Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor - (PTV)</b> .....	16
2.1 Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike.....	17
2.2 Zbatimi i trajnimeve sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve .....	20
2.4 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore.....	20
2.5 Trajnimet e përbashkëta me odat e profesioneve të lira.....	20
2.6 Trajnimet për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial .....	21
2.8 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë .....	21

<b>Objektivi III: Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese.....</b>	<b>22</b>
3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë.....	22
3.2 Përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore .....	22
3.3 Avancimi i veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së .....	23
<b>Objektivi IV: Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese .....</b>	<b>23</b>
4.1 Zbatimi i Doracakut të ri për trajnues .....	24
4.2 Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT).....	24
<b>Objektivi V: Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.....</b>	<b>25</b>
<b>Objektivi VI: Transparenca dhe marrëdhënia me publikun.....</b>	<b>26</b>
<b>Objektivi VII: Riorganizim i brendshëm dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit .....</b>	<b>26</b>
7.1 Riorganizimi brendshëm dhe sistematizim i vendeve te punës.....	27
7.2 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit.....	27
7.3 Planifikimi i prokurimit dhe realizmi i suksesshëm me AQP.....	28
7.4 Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative në realizmin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë .....	28
<b>Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së 29</b>	
<b>8. Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së -2024 .....</b>	<b>30</b>
<b>9. Sfidat dhe rreziqet .....</b>	<b>39</b>
<b>10. Përfundimi.....</b>	<b>40</b>

## 1. Lista e shkurtesave

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ABEK – Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PST-Programi i Specializuar i Trajnimit

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

## 2. Hyrje

Bazuar në mandatin e saj ligjor, Akademia e Drejtësisë është e angazhuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe profesionistëve tjerë ligjor. Në funksion të kësaj është përgatitur Plani i Punës dhe Performancës për vitin 2024 në kuadër të cilit janë paraqitur objektivat dhe veprimet konkrete në zbatim të mandatit të saj të përcaktuar me ligj.

Qëllimi i Planit të punës dhe Performancës për vitin 2024 është identifikimi dhe përcaktimi i saktë i aktiviteteve në zbatim të programeve trajnuese të AD-së dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara me ligj duke marrë për bazë kapacitetet dhe resurset në njësitë përkatëse që ka ky institucion si edhe përvojën dhe praktikën më të mirë për përmbushjen e tyre.

Pjesë e Planit të Punës dhe Performancës së AD-së për vitin 2024 përveç aktiviteteve të përcaktuara sipas vlerësimit të nevojave trajnuese janë edhe masat dhe aktivitetet e përcaktuara me dokumentet strategjike nacionale në fushën e drejtësisë, veçanërisht të Strategjisë për Sundimin e Ligjit, Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, Programit Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut dhe të mekanizmave tjerë integruar. Përmes këtij dokumenti janë përcaktuar njësitë përgjegjëse, veprimet që do të ndërmerren për realizimin e tyre duke përfshirë periudhën kohore si dhe treguesit apo indikatorët që do të mundësojnë matjen dhe monitorimin e përmbushjes së rezultateve.

Në funksion të realizimit të Planit të punës dhe Performancës, AD ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara i cili është pjesë e këtij dokumenti.

## 3. Përmbushja e Planit të punës dhe të Performancës për vitin 2023 dhe sfidat gjatë realizimit të tij

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2023 është përmbushur në tërësi për këtë vit për të gjitha programet. Përtej aktiviteteve të planifikuara në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar edhe aktivitete shtesë si rezultat i kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për rrishtë ligjore të Kodit të Procedurës penale, aktivitete tjera në luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave për shkak të rasteve të shumta gjatë vitit, trajnime për hetimin dhe rikuperimin e aseteve, etj të cilat janë realizuar me financimin e projekteve. Vëmendje të veçantë kanë pasur tryezat për unifikim të praktikës gjyqësore në fushën penale, civile dhe administrative, konkluzionet e të cilave tashmë janë të qasshme për të gjithë gjyqtarët meqë janë publikuar në faqen e AD-së dhe në portalin e Gjykatës së Apelit. Po ashtu janë realizuar siç janë planifikuar programet e specializuara

për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, trajnimet për të drejtat e njeriut, drejtësinë për fëmijë, trajnimet në fushën e ndërmjetësisimit, krimit kibernetik në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor. Pjesa më e madhe e trajnimeve ashtu siç janë planifikuar edhe janë realizuar, ndërkaq një numër i vogël i trajnimeve janë anuluar pavarësisht aplikimit për shkak të mos pjesëmarrjes.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare është vazhduar zbatimi i trajnimit fillestar për 45 gjyqtarët dhe 5 prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e IX të cilët trajnimin e kanë filluar në muajin korrik 2022. Grupi i gjyqtarëve ka përfunduar sesionet e trajnimit teorik në muajin shkurt 2023 meqë kanë realizuar sesionet e trajnimit teorik intenzivisht në 5 ditë të javës dhe nga ky muaj kanë vazhduar sesionet e trajnimit praktik deri në muajin korrik 2023 në gjykatat përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit. Në kuadër të këtij trajnimit praktik, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore që kanë qenë sipas planit të punës. Grupi i prokurorëve kanë vijuar sesionet e trajnimit teorik në çdo javë, 2 ditë trajnimi teorik në AD dhe 3 ditë tjera trajnimin praktik në prokurori dhe kanë përfunduar në muajin korrik 2023.

Përveç kësaj gjenerate, nga muaji prill i vitit 2023 ka filluar trajnimi fillestar edhe për gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë). Gjyqtarët me kërkesën e KGJK-së kanë vijuar sesionet e trajnimit teorik intenzivisht në 5 ditë të javës në AD për 6 muaj me radhë. Më pas me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse. Ndërkaq prokurorët në koordinim dhe me kërkesë të KPK-së ngjashëm me gjeneratën paraprake kanë vijuar trajnimin fillestar paralelisht me 2 (dy) ditë të trajnimit teorik nga modulet e këtij programi në Akademi të Drejtësisë dhe 3 (tre) ditë tjera të javës trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit.

E veçantë e këtij viti ishin trajnimet bazike për 87 gjyqtarët porotë si rezultat i emërimit të tyre në këtë pozitë dhe përgatitja e tyre për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit porotë.

Përveç zbatimit të trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë janë zbatuar edhe një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve trajnuese për bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Këto aktivitete trajnuese kishin si qëllim përfshirjen sa më shumë të kësaj kategorie në trajnimet bazike nga moduli-aspekti penal material dhe procedural dhe aspekti civil material dhe procedural.

Janë realizuar edhe aktivitetet trajnuese për profesionistët tjerë ligjor, veçanërisht për ndërmjetësuesit, ndërkaq përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe profesionistë tjerë ligjor, pa përfshirur edhe bashkëpunëtorët profesional kanë përfituar edhe nga trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë.

Në kuadrin e vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është



zhvilluar procesi konform planifikimit. Janë përfshirë gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke i konsumuar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili ofron analizën e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2024, ecurinë e procesit, metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces.

Në fushën e publikimeve janë realizuar buletinet dhe modulet trajnuese sipas planifikimit, janë zhvilluar dhe publikuar konkluzionet për unifikim të praktikës gjyqësore ndërkaq ka vazhduar pezullimi i nxjerrjes së revistave meqë ende është në proces hartimi i udhëzuesit i cili do të funksionalizoj këtë proces.

Në sektorin e financave janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë rrjedh gjatë këtij viti e gjithashtu edhe plani i prokurimit është realizuar në përgjithësi.

Për përmbushjen e gjithë këtyre aktiviteteve ka pasur vështirësi të theksuara në radhë të parë buxhetit jo të mjaftueshëm. Kjo ka bërë që mjetet buxhetore të orientohen në trajnimin fillestar që është obligativ sipas ligjit ndërkaq trajnimet e vazhdueshme një pjesë e konsiderueshme mandatorë sipas kërkesave nga dokumentet strategjike të gjinden alternativa me donatorë. Në kuadrin e trajnimeve janë zbatuar trajnime për dy gjeneratat të gjyqtarëve dhe prokurorëve pothuajse paralelisht. Kjo për shkak se KGJK dhe KPK ende pa përfunduar gjenerata e IX-të trajnimin fillestar ka realizuar procesin e ri të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj që shënojnë gjeneratën e X për AD-në. Krahas këtyre vështirësive, Akademia e Drejtësisë për herë të parë është përballë edhe me zbatimin e trajnimit të detyrueshëm pas kërkesës së KPK-së për një nga prokurorët si rezultat i vlerësimit të performancës. Për këtë lloj trajnimi është zbatuar protokollin i përbashkët për trajnime të detyrueshme me KPK-në duke zbatuar me përpikëri programin, testin dhe proceset tjera që kërkon ky protokoll. Gjithashtu ka pasur mungesë të ekspertizës, vështirësi në koordinimin e programeve dhe trajnuesve për zbatimin e trajnimeve. Me gjithë këto, falë angazhimit dhe mbështetjes së partnerëve të saj është arritur përmbushja e planit dhe performancës për vitin 2023.

## Vizioni dhe misioni

Akademia e Drejtësisë është institucion shtetëror i edukimit dhe aftësimit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, faktor kyq për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që duhet të gëzojë besimin e publikut.

Akademia e Drejtësisë ofron trajnime cilësore për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, harton analiza, zhvillon hulumtime dhe veprimtari botuese, në

përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe standardet e mira ndërkombëtare.

## Rëndësia e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2024

Bazuar në nenin 3 dhe 4 të Ligjit nr. 05/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe Rregullores nr. 3/2020 për performancën e agjencive, Akademia e Drejtësisë ka hartuar Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2024. Ky dokument është instrument thelbësor për përcaktimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara me ligj.

Plani i punës dhe i Performancës është dokument i cili për një vit orienton punën e secilës njësi brenda institucionit. Njëkohësisht përcakton kuadrin brenda institucionit të cilat duhet të angazhohen në aktivitetet përkatëse si dhe proceset që duhet zhvilluar dhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve.

Për përmbushjen e këtij plani, AD do të angazhohet në menaxhimin e punës dhe bashkërendimin e aktiviteteve në mes programeve dhe shërbimeve tjera që ofron sipas ligjit si dhe në koordinimin me institucionet dhe përfituesit e saj sipas ligjit. Gjithashtu do të angazhohet që në mënyrë sistematike të përcjellë të arriturat e përcaktuara në këtë plan.

## Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L -095 për AD-në, si dhe me plotësim Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, Akademia themelohet si institucion publik i pavarur e cila si funksion kryesor ka ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira përmes zbatimit të trajnimeve dhe zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe materialeve tjera ligjore.

Vija llogaridhënëse sipas *Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura* është te Këshilli Drejtues i saj. Përveç legjislacionit bazë janë edhe aktet nënligjore të rishikuar gjatë vitit 2023 si në vijim:

- Rregullorja Nr. 01/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 02/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 03/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 04/2023 - Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit

Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;

- Rregullore Nr.5/2023 Për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë

Ndërkaq janë edhe aktet tjera nënligjore si në vijim:

- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;

## Organet e Akademisë së Drejtësisë

### Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues si organ më i lartë i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2024 do të fokusohet në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si në vijim:

- Raporti vjetor për vitin 2023
- Planin e Integritetit të AD-së për vitin 2024-2026
- Listën e trajnuesve të përkohshëm
- Listën e mentorëve
- Procedurat dhe Standardet për publikim
- Projekt buxhetin e Akademisë së Drejtësisë
- Formimin e komisioneve për revistat e AD-së dhe komisione tjera tjera që dalin sipas nevojës për funksionimin më të mirë të AD-së;
- Kërkesat e KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që janë në proces të rekrutimit;
- Programin Trajnues dhe Planin e Performancës për vitin 2025 si dhe çështje tjera që dalin gjatë vitit 2024.

### Këshilli Programor

Këshilli Programor si organ profesional për vitin 2024 do të angazhohet për të siguruar cilësi për programet trajnuese dhe trajnimet e ofruara. Lidhur me këtë do të fokusohet në çështjet si në vijim:

- Hartimin e programit trajnues për vitin 2025
- Shqyrtimin e listës së trajnuesve dhe mentorëve dhe mendim për listën e trajnuesve potencial për Këshillin Drejtues
- Sigurimin e kualitetit të programeve trajnuese përmes orientimit të

- metodave dhe teknikave trajnuese si dhe do të
- Përcjellë e realizimin e programeve dhe suksesin e tyre.

## Drejtori Ekzekutiv i Akademisë

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë do të angazhohet në prioritet si në vijim:

- Përfaqësimin e Akademisë në institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- Do të siguroj zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues
- Do të propozoj projektbuxhetin vjetor të Akademisë;
- Do të propozoj Planin e punës dhe të Performancës si dhe Programin trajnues të Akademisë për vitin 2025
- Do të propozoj listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista do të caktoj trajnuesit për zbatim të programit;
- Do të Menaxhoj me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- Do të propozoj Projekt Rregulloret.

## Objektivat e Planit të Punës për vitin 2024

- Përgatitja profesionale e gjyqtarëve të sapo emëruar dhe prokurorëve të sapo emëruar
- Avancimi i vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor-PTV;
- Zhvillimi i programeve trajnuese, përmes analizave, hulumtime si dhe veprimtarisë botuese;
- Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese
- Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.
- Transparenca dhe marrëdhënia me publikun
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve të departamentit për administratë dhe financa

### **Objektivi I: Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar - PTF**

Bazuar në Programin e Trajnimit Fillestar për gjeneratën e X-të (2023-2024) të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar do të vazhdojë realizimi i sesioneve trajnuese për 29 gjyqtarët dhe 21 prokurorët e kësaj gjenerate deri në muajin maj 2024.

Gjyqtarët do të vazhdojnë sesionet e trajnimit praktik në 5 ditët e javës në gjykatat ku janë të emëruar. Gjatë kësaj periudhe do të asistojnë në aktivitetet gjyqësore sipas planit në mbikëqyrjen e mentorëve gjyqtarë. Mentorët në baza javore do të informojnë Akademinë e Drejtësisë për ecurinë dhe zhvillimet gjatë trajnimit praktik.

Prokurorët do të vazhdojnë paralelisht sesionet e trajnimit teorik me sesionet e trajnimit praktik, pra dy ditë të javës sesionet e trajnimit teorik ndërkaq tre ditë tjera sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë ku janë të emëruar. Ngjashëm si gjyqtarët edhe prokurorët për trajnimin praktik do të mbikëqyrjen nga mentorët e tyre prokurorë.

Krahas kësaj gjenerate, AD do të zbatojë trajnimin fillestar edhe për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të cilët pritet të dekretohen deri në fund të vitit 2023. Këshilli Gjyqësor ka zhvilluar procesin e rekrutimit për 47 kandidatë për gjyqtarë, ndërkaq sipas rezultateve do të dihet saktë numri në fund të procesit. Përveç tyre Këshilli Gjyqësori Kosovës ka shpallur konkursin për 8 pozita të gjyqtarëve nga komuniteti serb të cilët pritet të përfshihen në trajnimin fillestar gjatë vitit 2024.

Andaj, Programi i Trajnimit Fillestar për vitin 2024, do të fokusohet në objektivat specifike si në vijim:

1. Zbatimin e trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X në trajnimin praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë.
2. Zbatimin e trajnimit fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë.
3. Zbatimin i trajnimit fillestar për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës e XI në trajnimin teorik dhe praktik.
4. Zbatimin i trajnimit fillestar për 8 gjyqtarët nga komuniteti serbë të sapo emëruar të gjeneratës e XII në trajnimin teorik dhe praktik.
5. Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë
6. Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII në trajnimin teorik dhe praktik.
7. Zhvillimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës

### 1.1 Zbatimin e trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X

Trajnimi fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X i filluar me 24 prill 2023 do të vazhdojë edhe më tej gjatë vitit 2024. Gjatë kësaj periudhe do të realizohen sesionet e trajnimit praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e

mentorëve përkatësisht deri në maj të vitit 2024. Mentorët në baza javore do të mbajnë të informuar Akademinë e Drejtësisë për zhvillimet dhe rezultatet e trajnimit praktik.

Bazuar në strukturën dhe kalendarin e këtij programi pas përfundimit të trajnimit praktik do të realizohet testi përfundimtar me rezultatet e të cilit përmbyllet programi fillestar për këtë gjeneratë. Stafi përgjegjës i këtij programi do të angazhohet edhe në përmbledhjen e vlerësimeve për detyrat dhe angazhimet tjera të gjyqtarëve gjatë trajnimit fillestar dhe do të hartojë raport për çdo njërin prej tyre për KGJK-në, përkatësisht për Komisionin e Vlerësimit të Performancës.

## 1.2 Zbatimin e trajnimit fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X

Trajnimi fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X i filluar me 24 prill 2023 paralelisht me grupin e gjyqtarëve do të vazhdojë edhe më tej deri në muajin maj të vitit 2024. Gjatë kësaj periudhe në 5 ditë të javës, 2 ditë sesione të trajnimit teorik dhe 3 sesione të trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit. Në kuadër të sesioneve të trajnimit teorik do të vazhdojnë sesionet nga modulet: Kodi i Procedurës Penale, Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar, Shkathtësitë personale dhe nder personale dhe Legjislacioni dhe Shkathtësitë Plotësuese.

Mentorët e prokurorëve do të zbatojnë mentorimin e prokurorëve gjatë trajnimit praktik dhe Akademinë e Drejtësisë në baza javore do ta mbajnë të informuar për rezultatet e trajnimit praktik. Në kuadrin e trajnimit praktik, prokurorët e sapo emëruar do të vijojnë edhe trajnime në institucione jashtë gjyqësore.

Bazuar në strukturën e programit pas përfundimit të sesioneve të trajnimit teorik dhe praktik do të realizohet testi përfundimtar me rezultatet e të cilit përmbyllet programi fillestar edhe për këtë gjeneratë të prokurorëve. Ngjashëm si për gjyqtarë stafi përgjegjës i këtij programi do të angazhohet edhe në përmbledhjen e vlerësimeve për detyrat dhe angazhimet tjera të prokurorëve gjatë trajnimit fillestar dhe do të hartojë raport për çdo njërin prej tyre për KPK-në, përkatësisht për Komisionin e Vlerësimit të Performancës.

## 1.3 Zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të sapo emëruar dhe për komunitetin serb

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, Akademia e Drejtësisë ka bërë përgatitjet paraprake për të zbatuar trajnimin fillestar për këtë gjeneratë. Në koordinim me KGJK-në ka përcjellë procesin e rekrutimit të gjyqtarëve të rinj dhe në hap me këto zhvillime është angazhuar në hartimin/përditësimin e programit fillestar në

përputhje me ndryshimet e reja legjislative. Konkursi ka ofruar 47 vende të lira për gjyqtarë ndërkaq pas përfundimit të rekrutimit në listën për dekretimi janë propozuar vetëm 15 gjyqtarë. Programi për këtë gjeneratë, do të përmbajë trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, duke përfshirë edhe Acuis Communautaire, KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare si dhe kompetencën interdiscipinare.

Në kuadër të këtij programi për gjyqtarë të sapo emëruar do të realizohen trajnimet nga 6 modulet trajnuese. Modulet që do të trajtohen gjenden si në vijim.

- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale
- E drejta civile administrative dhe ekonomike
- Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare
- Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese

Ngjashëm sikurse me gjeneratën paraprake, trajnimi do të fillojë së zbatuari menjëherë pas dekretimit dhe do të vazhdojë me zbatimin e trajnimit teorik dhe praktik njëkohësisht për një periudhë prej 12 muajsh.

#### 1.4 Zbatimin e trajnimit fillestar për 8 gjyqtarët nga komuniteti serbë të sapo emëruar të gjeneratës e XII në trajnimin teorik dhe praktik.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka bërë të ditur nevojën për shtimin e gjyqtarëve edhe nga radhët e minoritetit serb. Në muajin tetor 2023 ka hapur konkursin për 8 pozita të lira për gjyqtarë të komunitetit serb dhe sapo të përfundojë ky proces këta gjyqtarë do të nënshtrohen trajnimit fillestar menjëherë, që potencialisht fillimi i këtij trajnimi mund të jetë tremujori i parë i vitit 2024. Për këtë grup të gjyqtarëve, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në koordinimin ndërinstitucional me KGJK si për hartimin e programit trajnues ashtu edhe për zbatimin e trajnimit fillestar për këtë gjeneratë.

#### 1.5 Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI trajnimi teorik dhe trajnimin praktik

Ngjashme si Këshilli Gjyqësor edhe Këshilli Prokurorial ka bërë të ditur nevojën për shtimin e prokurorëve përkundër asaj që ende nuk ka hapur zyrtarisht konkurs. Si do që të jetë, Akademia e Drejtësisë sipas ligjit obligohet të përcjellë zhvillimet edhe më tej prandaj do të merre gjitha masat që sapo të ndodhë ky proces të përmbush mandatin e saj me ligj përmes koordinimit ndërinstitucional me KPK si për hartimin e programit trajnues ashtu edhe për zbatimin e trajnimit fillestar për këtë gjeneratë.



## 1.6 Zbatimin e trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII në trajnimin teorik dhe praktik.

Përveç grupit të gjyqtarëve nga minoriteti serb, Këshilli Gjyqësor i Kosovës planifikon edhe më tej deri në fund vit rekrutime tjera nga radhët e gjyqtarëve që sipas planifikimit do të jenë edhe 30 pozita të reja. Për Akademinë e drejtësisë ky grup shënon gjeneratën e XIII, prandaj edhe për këtë gjeneratë Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në koordinimin ndërinstitucional me KGJK si për hartimin e programit trajnues ashtu edhe për zbatimin e trajnimit fillestar për këtë gjeneratë.

## 1.7 Zhvillimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës

Akademia e Drejtësisë do të jetë e gatshme të angazhohet në realizimin e trajnimeve të detyrueshëm për gjyqtarë dhe prokuror me performaca të pamjaftueshme varësisht nga kërkesat e KGJK dhe KPK.

### **Objektivi II: Avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor - (PTV)**

Trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial është kërkesë ligjore që rezulton nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë. Përveç kësaj rritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të funksioneve përkatëse e kërkon edhe Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026 pa përjashtuar edhe një varg dokumentesh tjera strategjike të cilat Akademinë e Drejtësisë e bëjnë përgjegjëse qoftë si të vetme apo edhe në koordinim me KGJK dhe KPK-në.

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2024 në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme do të përfshijë aktivitetet trajnuese që janë rezultati kërkesave nga të gjitha dokumentet strategjike, prioritetet e KGJK-së dhe KPK-së dhe nga vlerësimi i nevojave trajnuese që janë identifikuar nga takimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetar të gjykatave dhe kryeprokuror të prokurorive. Të gjithë këta mekanizma kanë konfirmuar trajnimet për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit, formave tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhunës në familje, aspektin e të drejtave të njeriut si dhe çështjet tjera që janë sfiduese të praktikës gjyqësore. Këshilli Programor si organ profesional do të përcaktoj përfituesit, kohëzgjatjen dhe metodologjinë për secilën prej tyre.

Prioritet i lartë i AD do të mbetet edhe më tej vazhdimi i ofrimit të trajnimeve për gjyqtarët dhe stafin mbështetës të Gjykatës Komerciale, trajnimet për bashkëpunëtorët profesional dhe Stafin tjetër mbështetës të gjykatave dhe prokurorive të cilat do të dizajnohen sipas detyrave të punës, përvojës si dhe



kompetencave specifike që ka secili prej tyre në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Vëmendje të veçantë do të kenë edhe profesionistët e tjerë ligjor, veçanërisht ndërmjetësuesit, përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe jo vetëm.

Për të përmbushur gjithë këtë spektër të trajnimeve të vazhdueshme do të listohen si në vijim:

1. Trajnimet sipas Strategjisë për sundimin e Ligjit 2021-2026 dhe dokumenteve tjera strategjike;
2. Trajnimet sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së;
3. Trajnimet sipas nevojave trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
4. Tryezat për unifikim të praktikës gjyqësore
5. Trajnimet e përbashkëta
6. Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive
7. Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive
8. Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
9. Trajnimeve për profesionet e lira
10. Trajnimeve për trajnues si dhe
11. Trajnimet përmes platformës së mësimin në distancë.

## 2.1 Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike

**Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026** përcakton një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve dhe trajnimeve që duhet të përfshihen në Planin e punës dhe të performancës së AD-së. Ato janë mandatore për programin trajnues të AD-së prandaj si të tilla do të jenë prioritet për AD-në dhe do të vazhdohet sipas ecurisë dhe planit të përcaktuar për secilën prej tyre. Sipas strategjisë janë 42 masa prej të cilave janë mbet si në vijim:

- Ofrimi i trajnimeve për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës në KGJK dhe KPK,
- Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në fusha të specializuara komerciale.
- Sesione të rregullta të Trajnimit të Trajnerëve (TiT).
- Ofrimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për të gjithë anëtarët e rinj dhe të vjetër të KZR-së.
- Trajnime të specializuara të mbështetjes për Komisionin e Vlerësimit të kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorëve (KP).

- Trajnime për njësitë ekzistuese të verifikimit të KPK-së me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në verifikim.
- Trajnimi për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për konfiskimin e pasurisë
- Trajnime bashkëpunuese të sponsoruar në mes të PK, prokurorëve dhe gjyqtarëve për arsye të koordinimit më të mirë sa i përket të kuptuarit reciprok të kodeve dhe ligjeve relevante
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për stafin e ANJF-së, gjyqtarë dhe prokurorë
- Zbatimi i programeve të specializuara të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë në lidhje me natyrën gjinore të akteve të dhunshme ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, dhe zbatimin e Udhëzimeve për Dënime në Kosovë
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta tematike për profesionet e lira me gjykatësit, prokurorët, stafin mbështetës nga gjykatat dhe zyrat prokuroriale, me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të përmirësuar ndër-institucional në mes të MD, AD dhe odave përkatëse.
- Trajnime të specializuara kundër korrupsionit për të gjithë gjyqtarët e caktuar.

Nga kjo strategji, vëmendje të veçantë do të kenë aktivitetet trajnuese dhe veçanërisht trajnimet e përbashkëta, trajnimet e specializuara kundër korrupsionit për të gjithë gjyqtarët e caktuar si në vijim:

- PST për Krimin kibernetik
- PST për Shpëlarjen e parave dhe hetimin financiar
- PST për Korrupsionin zyrtar dhe veprat penal kundër detyrës zyrtare
- PST për Ekstremizmin, radikalizmin dhe terrorizmin
- PST për Dhunën në familje
- PST për Krimet e luftës
- Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

Këto programe me përjashtim të Krimin Kibernetik dhe dhunës në familje do të realizohen në formë të tryezave me nga dy sesione. Përfitues të këtyre aktiviteteve do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për krime të rënda, departamentit special, bashkëpunëtor profesional nga gjykata dhe prokuroria – departamenti special si dhe ekspert nga PSRK. Gjithashtu do të përfshihen edhe zyrtarë tjerë ligjor të cilët në faza të caktuara janë pjesë e procedurës gjyqësore si: zyrtarë policor hetues, zyrtarë të NJIF, mbrojtës të viktimave si dhe zyrtarë nga institucione tjera që kanë fushëveprim luftimin e veprave përkatëse.

Disa nga aktivitetet sipas kësaj strategjie do të jenë sfiduese për AD-në me theks te trajnimet dedikuar komisioneve, organeve, veprimtaria e të cilëve është

vlerësimi i performancës, verifikimi e çështje tjera që janë pjesë e punës së KGJK-së dhe KPK-së e për të cilat AD nuk ka pasur përvojë në këtë drejtim. Sidoqoftë AD do të angazhohet në përmbushjen përmes koordinimit dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe ekspertizës së jashtme.

**Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut-Plani i veprimit 2021-2023**, po ashtu kërkon e rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me fokus në lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Andaj edhe AD do të përfshijë aktivitetet si në vijim:

- Trajnimin për procedurën penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore
- Trajnimin për rastet e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga viktimat
- Trajnimi për mos diskriminimin
- Trajnimi për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut
- Trajnimi për Lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës;
- Trajnimi për ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, alimentacioni, mbajtja financiare e bashkëshortit-es.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre aktiviteteve do të realizohet përmes mbështetjes së donatorëve, veçanërisht përmes projekteve të Këshillit të Evropës.

**Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026** gjithashtu kërkon rritjen e profesionalizmit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe përveç kësaj edhe në rastet kur përfshihen kryes me çrregullime mendore. Andaj, Plani i Punës dhe i Performancës së AD-së do të ketë prioritet realizimin e trajnimeve në këtë fushë. Bazuar në kërkesat që dalin nga ky dokument strategjik, 7 sesione trajnuese duhet të realizohen për dhunën në familje (aspekti penal dhe civil) si dhe 2 sesione trajnuese për rastet kur në procedurë përfshihen kryesit me çrregullime mendore. Gjithashtu në saje të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, përmes Projektit “Përafrimi i legjislacionit me Konventën e Stambollit” do të rishikohet kurrikula aktuale e trajnimit dhe mbi bazën e kësaj edhe modulet trajnuese.

## 2.2 Zbatimi i trajnimeve sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese të gjyqtareve dhe prokurorëve

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në akomodimin e kërkesave dhe prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së. Në radhë të parë në zbatimin e trajnimeve të detyrueshme që janë rezultat i obligimeve ligjore dhe akteve nën ligjore të KGJK-së dhe KPK-së nëse do të ketë kërkesa nga të dy institucionet. Në zbatimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë sipas propozimeve në programin trajnues 2024 si dhe në zbatimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor që është kërkesë ekskluzive nga KGJK. Bazuar në kërkesën e KGJK-se aktivitetet trajnuese për gjyqtarë do të realizohen në metodologjinë e kërkuar përmes tryezave të diskutimit si forma më të përshtatshme për adresimin e sfidave dhe problemeve praktike në gjyqësor.

Programi i trajnimeve të vazhdueshme do të ofrojë edhe trajnime tjera sipas nevojave dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për të siguruar cilësi do të angazhohen trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe profesionistë tjerë ligjor me përvojë dhe performancë të shkëlqyer në fushën e zbatimit të ligjit. Trajnimet do të dizajnohen me target gjyqtarët dhe prokurorët kompetent dhe do të realizohen përmes metodologjisë së studimit të rasteve dhe metodave tjera trajnimit gjyqësor.

## 2.4 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore

Programi trajnues i AD-së do të vazhdojë të ketë në fokus tryezat për unifikim të praktikës gjyqësore si një nga metodat më të përshtatshme për të ngritur dhe avancuar njohuritë e gjyqtareve dhe prokurorëve në fusha dhe tema të caktuara. Andaj edhe për vitin 2024 AD do të realizojë tryezat me gjyqtarë dhe prokurorë në të cilat do të adresohen çështje të ndryshme ligjore. Për këto tryeza do të angazhohen gjyqtarë dhe prokurorë të departamenteve të nivelit të Apelit dhe nivelit Suprem. Produkt i këtyre tryezave do të jenë konkluzionet për unifikimin e praktikës adekuate konform ligjeve në fuqi, hartimin e doracakëve, udhëzuesve etj të cilat do të vazhdojnë të publikohen dhe të jenë të qasshme për zbatuesit e ligjit.

## 2.5 Trajnimet e përbashkëta me odat e profesioneve të lira

Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit me odat e profesioneve të lira dhe kërkesave nga dokumentet strategjike, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave trajnuese të përbashkëta. Veçanërisht me mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit, përmbaruesit, zyrtarët e ndihmës

juridike falas dhe profesionistë tjerë ligjor puna e të cilëve lidhet me punën e gjykatave dhe prokurorive.

## 2.6 Trajnimet për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë me zbatimin e trajnimeve sipas moduleve të trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të cilët nuk kanë vijuar këto trajnime. Fokusi thelbësor do të jetë në përfshirjen e gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në gjykata dhe prokurori edhe trajnimet te tjera sipas kërkesave dhe nevojave të parashtrua në AD.

Siç e kërkon Strategjia për sundimin e Ligjit, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të Gjykatës Komerciale do të përfitojnë edhe nga trajnimet dedikuar gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale.

Stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial po ashtu do të kenë mundësinë e ndjekjes së moduleve të dizajnuara sipas detyrave të punës. Bazuar në Programin trajnues për vitin 2024, Akademia e Drejtësisë do të fokusohet në zbatimin e trajnimeve sipas moduleve që përfshijnë aspektin profesional dhe interdisiplinar.

## 2.8 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Edhe pse platforma e mësimin në distancë Moodle e AD-së, ende nuk është pasuruar me ndonjë kurs të ri për shkak të sfidave dhe vështirësive të theksuar në fillim të këtij dokumenti, megjithatë nuk ka munguar përkushtimi në këtë drejtim. Gjatë vitit 2023 në bashkëpunim me sekretariatit e Këshillit të Evropës dhe programin e HELP ka zhvilluar një sërë aktivitete të cilat ishin kryesisht në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, qasjes së grave në drejtësi si dhe arsyetimit dhe shkrimit ligjor. Këto kurse trajnuese nga platforma HELP, Akademia e Drejtësisë synon ti përfshijë në programin e saj trajnues për vitin 2024. Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës AD veçse ka identifikuar kurset e përkthyer dhe përshtatura në gjuhën shqipe, që për përfituesit e saj do jenë një ndihmë mjaft e madhe si në përfitimet profesionale dhe intelektuale ashtu edhe në kursimin e kohës.

Platforma HELP ka gjithsej 22 kurse në gjuhën shqipe, të cilat brenda mundësive AD do t'i sjellë për përfituesit e saj në programin e saj trajnues, kurse në bashkëpunim me KE nëse ndonjëri nga kurset është e mundur do të bartet edhe në platformën vendore atë të Moodle.

## **Objektivi III: Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese**

Analizat dhe hulumtimet kanë impakt në zhvillimin e programeve trajnuese adekuate me nevojat trajnuese dhe krijimin e botimeve të reja në fushën juridike me theks te modulet trajnuese, doracakët, udhëzuesit dhe format tjera që lehtësojnë punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve si përfitues kryesor sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Në këtë vështrim programi i PHP-së për vitin 2024 do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2025
- 3.2 Përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe publikimi i tyre
- 3.3 Avancimin e veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së
- 3.4 Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese

### **3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë**

Programi i PHP-së do të angazhohet në zhvillimin dhe zbatimin e procesit për vlerësim të nevojave trajnuese me qëllim që programi trajnues i AD-së të adresoj problemet e praktikës gjyqësore. Ky proces është me rëndësi të veçantë meqë i paraprin hartimit të programit trajnues andaj në pajtim me kornizën ligjore përkatësisht neni 6 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë do të realizohet procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë, prokuror si dhe stafit administrativ gjyqësor e prokurorial. Në këtë proces do të zbatohen në plotni mekanizmat për vlerësim të cilët janë në pajtim me standardet që kanë në qendër vlerësimin gjatë fazës së planifikimit dhe hartimit si dhe gjatë zbatimit të programit. Në fazën fillestare do të sigurohet identifikimi aktiviteteve mandatore për programin trajnues të AD-së të mbetura veçanërisht nga strategjitë në fushën e gjyqësorit që nuk janë realizuar për mungesë ekspertize ose buxheti. Në vijim nga anketat vlerësuese dhe pyetësorët duke përfshirë edhe takimet që do të realizohen me gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Do të konsultohen përfaqësuesit e gjitha gjykatave dhe prokurorive dhe udhëheqësit e degëve. Të gjitha resurset brenda programit do të angazhohen në analiza dhe hulumtime, në mbledhje të burimeve dhe informacioneve dhe në pajtim me strategjitë dhe prioritetet e gjyqësorit do të ofrohen për Këshillin Programor të AD-së për zhvillim të mëtejshëm.

### **3.2 Përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore**

Programi i PHP-së do të angazhohet në përmbledhjen e konkluzioneve pas trajnimeve dhe tryezave për praktikën gjyqësore që do të mbahen gjatë vitit 2024. Për të realizuar përmbledhjet do të nevojitet koordinimi me trajnuesit dhe

panelistët e aktiviteteve përkatëse për identifikimin e problemeve praktike. Në diskutimet e përbashkëta gjatë tryezave dhe aktiviteteve tjera të nxirren konkluzionet e përbashkëta të cilat do të shërbejnë si udhërrëfyes për praktikën gjyqësore unike.

### 3.3 Avancimi i veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së

Programi i PHP-së do të angazhohet në zhvillimin dhe avancimin e veprimtarisë botuese. Do të vazhdojë angazhimi dhe bashkëpunimi me PTF dhe PTV për përgatitjen e moduleve trajnuese në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara me doracakun për trajnues. Buletini informativ do të publikohet në baza periodike si dhe sipas nevojës dhe në koordinim me sistemin gjyqësor dhe prokurorial edhe doracakët, dhe format tjera të publikimeve me interes për komunitetin ligjor. Biblioteka elektronike AD-së me resurset e saj do të vazhdojë të jetë në funksion të përfituesve të saj dhe sipas nevojës edhe asistencë për qasjen e tyre sipas kërkesave. AD do të vazhdojë anëtarësimin në ABEK dhe me këtë rrjedhimisht pgesen vjetore shumë simbolike për të siguruar qasje në databaza të ndryshme ndërkombëtare që ky konzorcium i ofron për vende në zhvillim.

### 3.4 Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese

Akademia e Drejtësisë edhe për vitin 2024 do të vazhdojë vazhdoj në zbatimin e masave dhe politikave integruese. Në këtë drejtim Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zbatimin e rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë. Vëmendje të veçantë do të kenë gjetjet e raporti të KE-së për Kosovën me theks në rritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe formave tjera të korrupsionit. Gjithashtu do të vazhdojë të jetë konstruktive edhe në ofrimin e inputeve për këtë raport në baza të rregullta dhe rrjedhimisht në përmbushjen e agjendës evropiane.

Programi trajnues për vitin 2024 është hartuar duke marr parasysh rekomandimet dhe obligimet që dalin nga Strategjia e sundimit të ligjit, strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje, programi kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rekomandimet nga mekanizmat e agjendës për reforma evropiane ( ERA), PKZMSA, si dhe raporti për vendimin.

### Objektivi IV: Avancimi edhe më tej i metodologjisë trajnuese

Avancimi i metodologjisë trajnuese ishte dhe mbetet prioritet për AD-në. Kjo komponentet do të realizohet përmes:

#### 4.1 Zbatimi i Doracakut të ri për trajnues

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të avancimit edhe më tej të metodologjisë trajnuese ka hartuar Doracakun e ri për trajnues i cili përfshinë rregulla bazë të sjelljes së trajnuesve si mjet për të siguruar standardet më të larta gjatë trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor. Ky doracak me metodologjinë më të avancuar të mësimdhënies në fushën e mësimit për të rritur do të zbatohet në praktikë nga trajnuesit dhe stafi i AD-së.

Programi i certifikimit të trajnuesve i cili buron nga ky doracak siguron që të gjithë trajnuesit e AD-së janë të njohur me metodologjinë e mësimit për të rritur. Ky program do të zbatohet paraprakisht për gjitha trajnimet për trajnues që do të mbahen gjatë vitit 2024 përmes të cilit trajnuesit më pastaj do të aplikojnë projektimin, zhvillimin, realizimin dhe vlerësimin e trajnimit.

#### 4.2 Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT)

Trajnimet e Trajnuesve do të vazhdojnë të jenë rezultat i bashkëpunimit me projektet dhe donatorët e AD-së. Programi i trajnimit të trajnuesve i AD-së përbëhet nga një plan studimi i kombinuar me aspektet teorike dhe praktike duke j'u mundësuar trajnuesve të angazhuar në AD të pajisen me përvoja dhe teknikat e fundit në fusha të ndryshme duke filluar nga metodologjitë e trajnimit, gjuha e komunikimit, teknikat e të mësuarit për të rritur si dhe aspekte profesionale nga fusha penale, civile, interdisiplinare.

Në këtë komponentë Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunime të shumta me Institucione dhe organizata të ndryshme si: Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe gjitha projektet e saj, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadën Britaneze, OJQ të ndryshme që operojnë në vendin tonë.

Gjatë vitit 2024, AD synon që të vazhdojë bashkëpunimin me donatorët e saj duke zgjeruar programin e saj trajnues me disa fusha specifike në të cilat ka nevojë për rritjen e numrit të trajnuesve apo përditësimin e metodologjive dhe kurrikulave trajnuese.

Një prej fushave ku synohet që të vazhdohen trajnimet e trajnuesve është fusha e Kriminologjisë, trajnime kryesisht të mbështetura nga Këshilli i Evropës projekti i iPROCEEDS, pastaj Trajnim i Trajnuesve në fushën e Diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, Trajnim në fushën e lirisë së shprehjes dhe mediave dhe trajnime në fushën e antitrafikimit.

Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e TIT tjera do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse. Këtyre aktiviteteve i paraprijnë identifikimi i trajnuesve adekuat i cili fillimisht bëhet përmes shpalljeve publike



në web faqen e AD-së duke ju mundësuar të gjithë të interesuarve të drejta të barabarta në aplikimet e tyre, e pastaj duke përzgjedhur pjesëmarrësit varësisht përvojës së tyre, profilit të profesionit.

**Objektivi V: Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.**

Në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorive si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit, Akademia e Drejtësisë do të orientohet në këto objektiva specifike:

- 5.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës
- 5.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë
- 5.3 Avancimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare
- 5.4 Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

**5.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës**

Në funksion të zbatimit më të mirë të programeve trajnuese, Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë shumë ngushtë me KGJK dhe KPK veçanërisht për aktivitetet e mbetura që dalin si rezultat i Strategjisë për sundimin e Ligjit dhe për trajnime shtesë nëse do të ketë si rezultat i vlerësimit të performancës. Me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive do të vazhdojë koordinimi për trajnimet sipas aplikimit, gjithashtu edhe me administratorët për zbatimin e trajnimeve bazike për bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu ky bashkëpunim do të fokusohet edhe në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sipas nevojave dhe kërkesave të këtyre institucioneve dhe në shkëmbimin e informatave dhe çështjeve tjera në interes të përbashkët.

**5.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë**

Përveç bashkëpunimit me KGJK, KPK, Gjykata dhe Prokurori AD do të bashkëpunojë me Ministrinë e Drejtësisë veçanërisht në zbatimin e strategjive që kanë impakt në punën e gjyqësorit, dhe institucionet tjera që lidhen me punën e gjyqtarëve dhe prokurorët. Vëmendje të veçantë do të kenë edhe institucionet tjera të sistemit të drejtësisë me të cilat AD ka arritur marrëveshje bashkëpunimi

gjatë vitit 2024 e për të cilat do të ftohen të bëhen pjesë e programit trajnues varësisht prej çështjeve që janë me interes dhe që janë fushëveprim i tyre.

### 5.3 Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë përkushtimin e saj në projekte të përbashkëta ndërkombëtare edhe për gjatë vitit 2024. Në funksion të kësaj do të jetë pjesë e nismave të ndryshme rajonale e më gjerë veçanërisht në fushat specifike të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një gjyqësori profesional. Akademia do të mundësojë trajnuesve dhe veçanërisht përfituesve të saj pjesëmarrjen në trajnime, forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme në institucione të trajnimit gjyqësor në nivel rajonal si dhe në organizata tjera të cilat kanë në fokus avancimin e trajnimit gjyqësor si dhe sundimin e ligjit.

Gjatë vitit 2024, AD planifikon një pjesë të konsiderueshme të trajnimeve ti realizojë në mbështetje dhe bashkëpunim me OPDAT, USAID /Drejtësia Komerciale, WBROLI/CHEMONICS, KE/IPROSEEDS, INL, AIRE Centre, EJTN, IRZ-EUKOJUST, PRO FREX, PECK III, UNDP, GIZ, IRZ, UNODC, EULEX, OSBE, HUMANITARIAN LAW CENTER KOSOVO si dhe iniciativat të mbështetura nga KE, BE dhe të tjera.

Në kuadër të bashkëpunimit me këta mekanizma do të ketë mbështetje në zbatimin e trajnimeve për hetime financiare, shpëlarjen e parave, në fushën e të drejtave të njeriut, drejtësisë për fëmijë, ngritjen e kapaciteteve trajnuese për konfiskimin, financimin e terrorizmit, në risitë sa i përket Kodit të Procedurës penale, si dhe në fusha tjera relevante për gjyqësorin.

### **Objektivi VI: Transparenca dhe marrëdhënia me publikun**

Edhe për gjatë vitit 2024, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të rrit transparençën dhe marrëdhënien me publikun përmes publikimit të gjitha proceseve të punës dhe aktiviteteve të saj. Do të vazhdojë përfshirja e shoqërisë civile në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe perspektiva e saj për programet trajnuese të AD-së. Web faqja e AD-së dhe platforma e rrjeteve sociale do të përditësohet me zhvillimet e reja qoftë për punën e organeve të saj drejtuese ashtu edhe aktivitetet trajnuese përmes njoftimeve publike, shpalljeve dhe formave tjera.

### **Objektivi VII: Riorganizim i brendshëm dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit**

Shërbimet e përgjithshme dhe financat sipas kompetencës ligjore do mbështesin realizmin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në fushën e trajnimeve në kuadër të veprimtarisë hulumtuese dhe botuese dhe aktivitete tjera mbështetëse. Prioritet do të jetë edhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, plotësimi i pozitave të lira sipas rregullores për organizimin e brendshëm të AD-së dhe kapaciteteve buxhetore, përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë informative, furnizimet dhe mirëmbajtja e objektit, zhvillimi i planit të prokurimit në bazë të nevojave të AD-së dhe planifikimi i buxhetit për vitet në vijim. Objektivat specifike në kuadrin e këtyre njësive do të fokusohen në këto çështjet si në vijim:

7.1 Riorganizimi brendshëm dhe sistematizim i vendeve të punës

7.2 Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit;

7.3 Planifikimin e prokurimit;

7.4 Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së teknologjisë informative për realizmin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë;

7.5 Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024.

## 7.1 Riorganizimi brendshëm dhe sistematizim i vendeve të punës

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2024 do të jetë e fokusuar në zbatimin e plotë të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, plotësimin e pozitave vakante. Aktualisht, Akademia e Drejtësisë ka 32 pozita të miratuara prej të cilave 25 janë të plotësuara dhe 7 pozita të tjera janë të lira të cilat do të bëhen konform Ligjit për zyrtarët publik. Me ligjin e AD, statusi i të punësuarave është konform ligjit për zyrtarët publik, dhe në këtë kuadër rregullimi i brendshëm organizativ, sistematizimi i vendeve të punës dhe plotësimi i pozitave vakante do të jetë prioritet. Akademia e Drejtësisë po ashtu do të jetë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve aktuale njerëzore dhe në këtë drejtim do t'i mundësoj stafit ndjekjen e trajnimeve të ndryshme përmes IKAP por jo vetëm, duke siguruar programe adekuate trajnimi, me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe mundësive të reja për zhvillim profesional.

## 7.2 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit

Buxheti i Republikës së Kosovës është burim kryesor financiar i Akademisë së Drejtësisë. Pjesë shtesë e këtij buxheti janë edhe donacionet e ndryshme të cilat ndihmojnë Akademinë e Drejtësisë në aktivitete të saj dhe përmbushjen e mandatit të përcaktuar me ligj. Divizioni për Buxhet dhe Financa do të angazhohet në përgatitjen e kërkesave buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara duke vlerësuar koston për të gjitha aktivitete të përfshira në buxhet. Për vitin 2024, qarkorja buxhetore ka parapare buxhetin në total **863,245.00** euro, përkundër që kërkesa buxhetore e AD-së ka qene **1,460,803.00**. Si rezultat i këtij realizmi i aktiviteteve trajnuese sikurse të

planifikuara në kuadër të PTF dhe PTV me buxhetin e aprovuar do jete shumë e vështirë pa ndihmën e partnerëve dhe donacioneve të tyre. Trajnimet fillestare janë trajnime te detyrueshme prandaj edhe mjetet buxhetore duhet të orientohen në këtë program që do të konsumojnë shumën më të madhe të buxhetit, respektivisht 518,759.00 euro vetëm nga mallrat dhe shërbimet. Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve do të mbulojnë shpenzimet e qirasë, ngrohjes mirëmbajtjes etj. Kërkesat e shumta për trajnime do te rrisin shpenzimet e përkthimit si atij simultant ashtu edhe përkthimi i moduleve te trajnimit dhe dokumenteve tjera.

Gjatë vitit 2024 planifikohet që realizimi i buxhetit të ekzekutohet në përqindjen maksimale.

Planifikimit buxhetor do ti paraprijnë takimet dhe vlerësimet brenda njësave organizative të cilat luajnë rol të rëndësishëm në këtë proces. Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet duke respektuar rregullat ligjore në fuqi, të cilat sigurojnë realizimin e planit dhe programit të Akademisë.

### 7.3 Planifikimi i prokurimit dhe realizimi i suksesshëm me AQP

Aktivitetet e prokurimit edhe lidhja e kontratave për Akademinë e Drejtësisë është nën autoritetin e AQP-së meqë kështu është e rregulluar për institucionet që kanë më pak se 50 staf të punësuar. Me këtë ligj ka ndryshuar edhe procesi i realizimit të aktiviteteve të prokurimit. Megjithatë, në fushën e prokurimit, Akademia do të angazhohet në planet për menaxhimin e kontratave dhe zbatimin e tyre në harmoni me legjislacionin në fuqi. Gjatë vitit 2024, Akademia sipas planifikimeve pritet të ketë për furnizime dhe shërbime të cilat janë të nevojshme në fushën e teknologjisë informative, për furnizim me naftë për ngrohje, furnizim me ushqim, pije për nevojat e trajnimeve si dhe furnizime tjera që janë të nevojshme për procesin e punës në Akademi të Drejtësisë. Gjithashtu do të ketë edhe kontrata për shërbime të përkthimit, servisim të klimave, akomodim në regjione për nevoja të trajnimeve si dhe shërbime tjera të nevojshme për të cilat Akademia do të duhet të kujdeset për specifikat e kontratave, caktimin e menaxherëve dhe çështjeve tjera me interes në këtë fushë.

### 7.4 Avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në përdorimin e teknologjisë informative për zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera. Prandaj, avancimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative do të vazhdojë të jetë ndër prioritetet e AD-së edhe për vitin 2024. Si fillim Divizioni i TI-së do të fokusohet në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e paisjeve harduerike dhe softuerike të AD-së si proces i vazhdueshëm i cili kërkon dhe ofron siguri dhe qëndrueshmëri për këto pajisje. Përveç kësaj do të vazhdoj edhe në ofrimin e përkrahjes së shërbimeve të TIK-ut për përdoruesit e TI-së në realizimin e objektivave të AD-së.

E veçantë për vitin 2024 do të jetë avancimi i njohurive në përdorimin e sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese si dhe përdorimin e ueb faqes me që ky sistem është zhvillim i ri dhe gjithsesi se ofron vegla të reja në menaxhim të të dhënave në përgjithësi.

Me qëllim të avancimit të infrastrukturës së TI në sallat trajnuese, Akademia në vitin 2024 planifikon blerjen e së paku një seti të përkthimit dhe zërimit.

Divizioni për TI do të angazhohet edhe në krijimin e kurseve të reja në platformën e mësimin në distance sipas nevojave dhe programeve trajnuese.

## Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së

Për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës për vitin 2024 janë përcaktuar shtatë objektiva të cilat janë reale me nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Plani i veprimit në vijim ka përcaktuar qartë: objektivat, njësinë përgjegjëse, afatet kohore, buxhetin si dhe indikatorët apo rezultatet që synohet të arrihen. Akademia e Drejtësisë do të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial duke përditësuar këtë plan varësisht nga kërkesat që mund të dalin si pasojë e ndryshimeve legjislative apo kërkesave tjera nga autoritetet relevante. Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Punës, bëhet përmes procesit të monitorimit i cili realizohet në baza periodike. Ky proces mbikëqyrë përmbushjen e indikatorëve si dhe sfidat dhe menaxhimin e rreziqeve.

Në planin me poshtë janë të listuara shtatë objektivat madhore të cilat janë në përputhje me nevojat si të pasqyruara me lart në planin e punës. Objektivat janë reale dhe të realizueshme, mirëpo sfide mbetet buxheti për arritjen e objektivave në fjale. AD në kërkesën buxhetore ka kërkuar 1,460,803.00 euro, ndërsa është aprovuar 863,245.00 euro, nuk korrespondon me aktivitetet e parapara dhe si të tilla me këtë buxhet do jete i pamundur të realizohen .

Andaj ne tabelën si me poshtë janë prezantuar aktivitetet dhe kostoja e tyre, duke u bazuar se buxheti do të rritet në masën e nevojave reale për realizimin e planit të punës 2024.

## 8. Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së -2024

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së X si dhe Hartimi dhe zbatimi i programeve për gjyqtarët e gjeneratës së XI, XII dhe XII dhe prokurorët e gjeneratës së XI	Zbatimi i trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X në trajnimin praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë) dhe realizimi i testit përfundimtarë.	Programi i trajnimeve fillestare (PTF)	Janar – Maj		BKK sa është buxheti	Raporti përfundimtar i hartuar për 29 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së X të trajnuar në modulet sipas Programit trajnues 2023-2024.
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX ( trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë) si dhe realizimi i testit përfundimtarë	(PTF)	Janar – Maj			Raporti përfundimtar i hartuar për 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X të trajnuar në modulet sipas Programit trajnues 2023-2024.
	Zbatimi i trajnimeve praktike për 21 prokurorët e sapo emëruar në institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe jashtë gjyqësore			Janar-Maj		

	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të rinj	(PTF)	Janar-Dhjetor			15 Gjyqtarët e sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e XI
	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XII të gjyqtarëve nga komuniteti serb	(PTF)	Mars -Dhjetor			8 Gjyqtarët e sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e XII
	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XI të prokurorëve të rinj	(PTF)	Qershor -dhjetor			30 prokuror e sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e XI
	Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XIII të gjyqtarëve	(PTF)	Korrik – dhjetor			30 gjyqtarë e sapo emëruar të trajnuar në modulet përkatëse sipas programit trajnues për gjeneratën e XIII
	Zhvillimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të performances	(PTF)	Janar-Dhjetor			Gjyqtarë dhe

						prokurore të trajnuar <sup>1</sup>
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor	Trajnimet nga lëmia Penale	(PTV)				9 trajnime, me deri 225 pjesëmarrje, 115 gjyqtarë, 60 prokuror, 40 bashkëpunëtor profesional
	Trajnime nga Programet e Specializuara në fushën Penale	(PTV)	Janar-Dhjetor		BKK buxheti	6 trajnime, me 120 pjesëmarrje deri 80 gjyqtarë, 30 prokurorë, 10 bashkëpunëtorë profesional dhe ekspert të PSRK-së të trajnuar
	Trajnimet nga lëmia Civile	(PTV)	Janar-Dhjetor			10 trajnime, me 200 pjesëmarrës deri 130 gjyqtarë, 70 bashkëpunëtor profesional
	Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë	(PTV)	Janar-Dhjetor			3 trajnime, me 50 pjesëmarrës deri 25 gjyqtar, 10 prokuror, 9 bashkëpunëtor profesionale, 3 shërbimi sprovues, 3 zyrtar policor

<sup>1</sup> Zbatimi i trajnimit te detyrueshem varet nga kerkesat e KGJK-se dhe KPK-se



	Trajnimet nga lëmia Komerçiale	PTV)	Janar-Dhjetor			11 trajnime me 110 pjesëmarrje deri 70 gjyqtarë, 40 bashkëpunëtor profesional
	Trajnimet nga drejtësia kushtetuese, administrative kundërvajtëse dhe Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme	PTV)	Janar-Dhjetor			7 trajnime me 90 pjesëmarrjes prej tyre 80 gjyqtar, 10 bashkëpunëtor profesional,
	Trajnimet për KEDNJ	PTV)	Janar-Dhjetor			4 trajnime me 90 pjesëmarrës prej tyre 49 gjyqtarë, 20 prokuror, 10 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor, 11 avokat shtetëror
	Trajnimet nga e Drejta e BE-së dhe e drejta ndërkombëtar	PTV)	Janar-Dhjetor			4 trajnime me 80 pjesëmarrës prej tyre 40 gjyqtar, 20 prokuror, 20 bashkëpunëtor profesional
	Trajnimet nga kompetenca interdisciplinare	PTV)	Janar-Dhjetor			2 trajnime me 60 pjesëmarrës prej tyre 35 gjyqtar, 15 prokuror, 10 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtare ligjor,
	Zbatimi i trajnimeve të obligueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	(PTV)	Janar-Dhjetor			Gjyqtarë dhe Prokurorë të trajnuar për trajnimet e obligueshme <sup>2</sup>

<sup>2</sup> Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar varet nga kërkesat e KGJK dhe KPK.

	Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive	(PTV)	Janar-Dhjetor			50 trajnime me rreth 170 bashkëpunëtorë profesional dhe 30 zyrtarë ligjor të trajnuar
	Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	(PTV)	Janar-Dhjetor			Deri 110 staf administrativ duke përfshirë Administratorë, ndihmës administratorë, shef ZML-së, referentë, zyrtarë të statistikave, sekretarë juridikë, arkivistë, zyrtarë për komunikim dhe media me publikun të gjykatave dhe prokurorive
	Ofrimi dhe zbatimi i trajnimeve sipas kërkesave të institucioneve të profesioneve të lira	(PTV)		NA		Përmbaues privat, mbrojtës të viktimave, zyrtarë të ANJF si dhe zyrtarë të OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas të trajnuar

	Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	PTV si dhe njësia e TI-së	Janar - Dhjetor			Gjyqtare e prokurore te trajnuar në kurset online
3. Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese	Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2025	Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)			BKK	Raporti me analizën dhe vlerësimin e nevojave trajnuese i hartuar
	Identifikimi i praktikës gjyqësore të drejtë dhe vënia në dispozicion për profesionistët ligjor	PHP	Janar-dhjetor			Përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe publikimi i tyre
	Zbatimi i veprimtarisë botuese	PHP	Janar dhjetor			Publikimi i buletineve, moduleve dhe formave tjera të publikimeve si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit e saj sipas ligjit
	Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese	AD	Janar-Dhjetor			-Përmbushja e masave nga strategjia për Sundimin e ligjit; -Përmbushja e masave nga Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje; -Përmbushja e masave nga Programi kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; -Përmbushja e masave

						nga PKZMSA; -Përmbushja e masave nga Raporti për vendin; -Përmbushja e masave nga agjenda për reformë evropiane ERA.  Raportet e hartuara dhe të dërguara sipas afatit për mekanizmat përkatës
4.Avancimi i mëtejshëm i metodologjisë trajnuese	Zbatimi i metodologjisë së mësimdhënies për të rritur në përputhje me Doracakun e ri për trajnues	AD	Janar-dhjetor			Raportet me planet e trajnimit të hartuara
	Zbatimi i trajnimit të trajnuesve	PTV	Janar - Dhjetor			2 trajnime për metodologjinë sipas doracakut për trajnues dhe 4 trajnime për trajnues në fushat specifike si: krimi kibernetikë, diskriminim dhe gjuhës së urrejtjes, për lirinë e shprehjes dhe medias dhe në fushën e antitrafikimit. Rreth 70 gjyqtarë, 20 prokurorë si dhe 10

						ekspert tjerë sipas ligjit të trajnuar
5. Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia me publikun	Ofrimi i qasjes për palët e interesit	AD	Janar-Dhjetor			Rreth 21 postime në linkedin, 84 në facebook si dhe në njoftimet dhe raportet në web sipas aktiviteteve të planifikuara qoftë në Programin trajnues ashtu edhe në aktivitete tjera në funksion të procesit të punës në AD
6. Ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit	Riorganizimi brendshëm dhe sistematizim i vendeve të punës	Departamenti për shërbime ligjore dhe të përgjithshme si dhe divizioni për buxhet dhe financa	Janar-Dhjetor		BKK	Riorganizim brendshëm dhe sistematizim i vendeve të punës i përfunduar,, dhe plotësimi i pozitave të lira
	Planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në pajtim me rregullat ligjore në fuqi	Divizioni për buxhet dhe financa	Mars-Tetor			Kërkesa buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara e hartuar dhe e aprovuar nga KD
	Planifikimin e prokurimit dhe menaxhimin e drejtë të kontratave	Prokurimi	Janar-Dhjetor			Plani i hartuar dhe i zbatuar

	Përdorimi i teknologjisë informative në realizmin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë	Divizioni për teknologji informative	Janar-Dhjetor	50,000		Lista e pajisjeve funksionale dhe sistemi për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese
	Ofrimi e shërbimeve të përgjithshme për funksionimin më të mirë të AD-së dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024	Departamenti për shërbime të përgjithshme	Janar-Dhjetor			Furnizimet dhe shërbimet e pranuar si dhe raporti i

Buxheti sipas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2024 dhe sipas qarkores buxhetore 2024/2 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;

Kategoria	2023	2024	Diferenca 2023-2024	Kerkesa Buxhetore 2024	Diferenca Kerkesë - Buxhet 2024
<b>Paga dhe Meditje</b>	244,867	<b>276,797</b>	31,930	<b>322,915</b>	<b>(46,118)</b>
<b>Mallra dhe shërbime</b>	435,000	<b>519,948</b>	84,948	<b>1,001,864</b>	<b>(481,916)</b>
<b>Shpenzime Komunale</b>	16,500	<b>16,500</b>	-	<b>20,700</b>	<b>(4,200)</b>
<b>Shpenzime Kapitale</b>	196,000	<b>50,000</b>	(146,000)	<b>50,000</b>	-
<b>Total Buxheti</b>	892,367	<b>863,245</b>	(29,122)	<b>1,395,479</b>	<b>(532,234)</b>

## 9. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i këtij plani përmban sfida dhe rreziqe, ndër të cilat janë si në vijim:

- Hapësira dhe kushtet e pamjaftueshme për të përmbushë gjitha aktivitetet nga programet trajnuese,
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit;
- Procesi i plotësim ndryshimit të Ligji për Akademinë e Drejtësisë konform nevojave;
- Stafi i pamjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve hulumtuese dhe kërkimore, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun;
- Procesi i rekrutimit për pozitat e lira sipas legjislacionit të ri në fuqi;
- Zbatimi i data bazës së re për menaxhimin e trajnimeve;
- Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme individuale nga vlerësimi i performances;
- Kërkesat e shumta të projekteve me donatorë për trajnime ad-hoc që nuk janë të planifikuara në Programin Trajnues;
- Sigurimi i pjesëmarrësve në trajnimet ad-hoc;
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Zhvillimi programit të përhershëm për trajnues dhe ngritja e kapaciteteve të trajnuesve;
- Zbatimi i doracakut për trajnues;
- Zbatimi i aktiviteteve nga Strategjia për sundimin e ligjit për të cilat ka mungese të ekspertizës;
- Mungesa e trajnimeve për stafin e AD-së;

Akademia e Drejtësisë do të hartoj një regjistër të veçantë ku do të parashihen të gjitha rreziqet e mundshme, shkalla e rrezikut, personat përgjegjës për adresimin e këtyre rreziqeve si dhe specifika tjera siç përcaktohet me të gjitha standardet relevante për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

## 10. Përfundimi

Plani i punës dhe i Performancës për vitin 2024 është dizajnuar përshtatshëmrisht me zhvillimet e reja dhe kërkesat në radhë të parë të dy këshillave, strategjive dhe nevojave trajnuese në të cilin janë përcaktuar në detaje aktivitetet nga programet përmes si dhe njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre. Staf i Akademisë do të angazhohet në përmbushjen e këtij plani duke i marrë në konsideratë veprimet dhe afatet e përcaktuara për çdo aktivitet të paraparë.